VENDIM
Nr. 6, datë 22.1.2024

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 161, DATË 17.6.2022, "MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË 'VOKOPOLA ENERGJI' SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC 'VOKOPOLA 1', ME KAPACITET TË INSTALUAR 274 kw, 'VOKOPOLA 2', ME KAPACITET TË INSTALUAR 3104 kw, DHE 'VOKOPOLA 3', ME KAPACITET TË INSTALUAR 2297 kw, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 5675 kw", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.1.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 168 prot., datë 16.1.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s n. 161, datë 17.6.2022, 'Mbi licencimin e shoqërisë 'Vokopola Energji' sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC 'Vokopola 1', me kapacitet të instaluar 274 kw, 'Vokopola 2', me kapacitet të instaluar 3104 kw, dhe 'Vokopola 3', me kapacitet të instaluar 2297 kw, me kapacitet total të instaluar 5675 kw", i ndryshuar,

konstatoi se:

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 161, datë 17.6.2022, të ndryshuar, ka vendosur:

1. Të licencojë shoqërinë "Vokopola Energji" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Vokopola 1", me kapacitet të instaluar 274 kw, "Vokopola 2", me kapacitet të instaluar 3104 kw, dhe "Vokopola 3", me kapacitet të instaluar 2297 kw, me kapacitet total të instaluar 5675 kw, për një afat 25 vjet e 8 muaj.

2. Shoqëria "Vokopola Energji" sh.p.k. të paraqesë në ERE kontratat e qirasë me afate të rinovuara, jo më vonë se data 21.12.2023 (me Bashkinë Skrapar dhe Memaliaj) dhe jo më vonë se data 31.10.2024 (me Bashkinë Poliçan), ose çdo dokumentacion tjetër që rregullon pronësinë.

- ERE me shkresën nr. 143/7 prot., datë 22.11.2023, i kërkoi shoqërisë depozitimin e kontratave të qirasë me Bashkinë Skrapar dhe Bashkinë Memaliaj me afate të rinovuara, brenda afatit të përcaktuar në vendimin e sipërcituar.

- Shoqëria "Vokopola Energji" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE nr.143/8 prot., datë 29.12.2023, depozitoi: kontratë qiraje nr. 3351 prot., datë 21.12.2023, për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik, nënshkruar mes Bashkisë Skrapar në cilësinë e qiradhënësit, dhe shoqërisë "Vokopola Energji" sh.p.k., në cilësinë e qiramarrësit me afat 1(një)-vjeçar, me të drejtë rinovimi për çdo vit, duke filluar nga e nesërmja e nënshkrimit të kësaj kontrate (afati i vlefshmërisë deri më 22.12.2024), kontratë qiraje nr. 2683 prot., datë 26.12.2023, për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik, nënshkruar mes Bashkisë Memaliaj, në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqërisë "Vokopola Energji" sh.p.k., në cilësinë e qiramarrësit me afat 1(një)-vjeçar, me të drejtë rinovimi për çdo vit, duke filluar nga e nesërmja e nënshkrimit të kësaj kontrate (afati i vlefshmërisë deri më 27.12.2024).

- Me depozitimin e kontratave të qirasë të rinovuara si më sipër cituar nga shoqëria "Vokopola Energji" sh.p.k., të cilat nuk mbulojnë të gjithë afatin e vlefshmërisë së licencës së shoqërisë, vlerësojmë që pika 2, e vendimit të Bordit nr. 161, datë 17.6.2022, të ndryshuar, duhet të ndryshojë duke i lënë detyrë shoqërisë që në përfundim të afatit të kontratave të qirasë t'i depozitojë ato me afate

të rinovuar, jo më vonë se data 22.12.2024, kontrata me Bashkinë Skrapar dhe jo më vonë se data 27.12.2024, kontrata me Bashkinë Memaliaj ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë në zonën ku shtrihet projekti. Duke qenë se kontrata me Bashkinë Poliçan e ka afatin e vlefshmërisë deri më datën 31.10.2024, si e tillë, afati për depozitimin e saj mbetet i pandryshuar sikurse në dispozitivin e vendimit nr. 161/2022, i ndryshuar.

- Në nenin 113, të "Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, apo ndryshimin e tij, me nismën e vet organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 161, datë 17.6.2022, të ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:

2. Shoqëria "Vokopola Energji" sh.p.k. të depozitojë në ERE kontratat e qirasë me afate të rinovuara, me Bashkinë Skrapar jo më vonë se data 22.12.2024, me Bashkinë Memaliaj jo më vonë se data 27.12.2024, me Bashkinë Poliçan jo më vonë se data 31.10.2024, ose çdo dokumentacion tjetër që rregullon pronësinë.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë "Vokopola Energji" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti